



## Njësia i Prokurimit

Istog: datë, 21.09.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.09.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Çeta-General Invest Group sh.p.k.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“RREGULLIMI I PARKUT MEMORIAL “IBRAHIM RUGOVA”-FAZA KATER.”**, me Nr. të Prok: **633-018-5660-5-2-1** nxjerr:

### VENDIM

1. **Aprovohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Çeta-General Invest Group sh.p.k** të dt. 13.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**RREGULLIMI I PARKUT MEMORIAL “IBRAHIM RUGOVA”-FAZA KATER.”**, me Nr. **633-018-5660-5-2-1** Nr. Brendshëm **633-018-055-521**, kundër **NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të AK –së, të datës 11.09.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. **Anulohet** vendimi i AK-se publikuar me datë: 11.09.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *aktivitetin e Prokurimit të ktheje në Rivlersim.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit